



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 8619 Prot

Lezhë, më 25/06/2020

VENDIM

Nr. 79 datë 25.062020

“Për

Miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i njësisë administrative si dhe dokumentacionit tjetër plotësues që vërtetojnë posedimin dhe gëzimin e vazhduar të banesave, si dhe vërtetimit të legalizimit dhe formularit të aplikimit, si dokumentacion që provojnë pronësinë e objektit për aplikuesit për programin e rindërtimit”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të VKM nr 904 datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të VKM nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i njësisë administrative si dhe dokumentacionit tjetër plotësues që vërtetojnë posedimin dhe gëzimin e vazhduar të banesave, si dhe vërtetimit të legalizimit dhe formularit të aplikimit, si dokumentacion që provojnë pronësinë faktike të objekteve për aplikuesit për programin e rindërtimit.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, administrata e Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

